

Nr. Prot. 008/B/20

VENDIM Nr. 1495

Për

Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të

“Draft Rregullores për çështjet teknike dhe operacionale të qasjes së rrjetit të komunikimeve elektronike në Bitstream”

Në mbështetje të nenit 1, nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.3), nenit 10, paragrafi 4), nenit 33, nenit 34, nenti 36, neni 37, nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe nenit 82, paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------|------------|
| 1) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar |
| 2) z. Hazir Hajdari, | Anëtar |
| 3) z. Bahri Anadolli, | Anëtar dhe |
| 4) z. Shqiprim Pula | Anëtar, |

në mbledhjen e 52-të me radhë të mbajtur më datë 31 Janar 2020, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe rekomandimit të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamentit Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të dokumentit ‘**Draft Rregullorja për çështjet teknike dhe operacionale të qasjes së rrjetit të komunikimeve elektronike në Bitstream**’.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **10 Shkurt, 2020** dhe përfundon më **09 Mars, 2020**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Neni 1 i Ligjit specifikon qëllimin e Ligjit si në vijim:

“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t’i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Rregullorja teknike dhe operative për qasjen e rrjetit të komunikimeve elektronike në bitstream (në tekstin e mëtejme – rregullorja) përcakton kërkesat teknike dhe operative të rrjetit të komunikimeve elektronike për shërbimin me shumicë të qasjes së brezit të gjerë (broadband) – qasjen në bitstream të cilat janë të detyrueshme për operatorët e detyruar që të ofrojnë qasje në bitstream, si dhe informacionet që do të përfshihen në ofertën e Referencës (OR) për qasje në bitstream dhe nivelin e detajeve të kërkuara.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 10/02/2020

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike,
- Departamentit Ligjor,
- Arkivës së Autoritetit.